

## **Programi i edukimit fizik i vlefshëm për provimin e shtetit në profesionin “Mësuesi”**

Në programin e edukimit fizik për provimin e shtetit janë përfshirë module dhe lëndë që i përkasin disiplinave të kulturës së përgjithshme, disiplinave karakterizuese, disiplinave integruese dhe veprimtarive sportive formuese. Sipas kësaj ndarjeje ato janë pasqyruar të detajuara si më poshtë:

### **I. Programi i lëndës: “Sociologji e EF dhe Sportit”**

Lënda trajton koncepte të përgjithshme të sociologjisë së sportit: marrëdhëniet që sporti krijon me kulturën në përgjithësi, me ideologjinë, vlerat, normat dhe funksionet me të cilat ai kontribuojnë shoqëri; marrëdhëniet e sportit me aspektet shoqërizuese, edukative, format e shfaqjes së dhunës dhe agresionit; lidhjet që ai krijon me sfera të mëdha të veprimitarisë shoqërore si politika, ekonomia, besimi fetar dhe media. Në këtë kuadër, do të mundësohet zbatimi i njohurive të marra nga studentët në një terren praktik për ta parë dhe për ta trajtuar sportin si dukuri shoqërore.

**Literatura:** 1.Fatos Gjata “Sociologji e Sportit I”,Shblu.2000;  
2.Fatos Gjata “Sociologji e Sportit II”,2010;  
3.Fatos Gjata “Sporti dhe Feja-Një perspektivë sociologjike”,2005.

### **II. Programi i lëndës: “Filozofi e EF dhe Sportit”**

Lënda synon të trajtojë disa koncepte bazë të filozofisë së edukimit fizik e sportit problematikat e të cilave përkojnë me natyrën, domethënien dhe metodat e filozofisë së sportit si dhe me statuset e mendimit filozofik për sportin (statusi llogjik, metafizik, epistemik, teologjik, aksiologjik - etik, estetik, etj.).

**Literatura:** 1. Fatos Gjata “Filozofi e Sportit”,2010

### **III. Programi i lëndës: “Psikologjia e Pergjithshme, e EF dhe Sportit”**

Proceset kognitive. Motivacioni. Emocioni. Personaliteti. Inteligjenca. Vemëndja. Sjellja anormale. Filozofia e trajnimit.

**Qëllimi:** Kompetencat: Aftesimi i mësuesve të rinj me zotërimin, përdorimin e koncepteve e njohurive themelore psikologjike që rrisin kuptimin e nxënësve, të tjerëve dhe sjelljeve të tyre.

**Literatura:** 1. Zhurda,Y. (2009). Psikologjia. Shblu. Tirane. Faqe: 70-73, 105-112, 119-121, 125-127. 146-147, 151-157. 165-168, 171-174, 176-177, 261-263. 219-222, 213-216. 234, 235-239, 244-248. 58-60, 61-65. 271-271, 275-276, 278-279, 282-283.

2. Leksione të shkruara.

### **IV. Programi i lëndës: “Histori e Edukimit Fizik dhe Sportit”**

Historia e Edukimit Fizik dhe Sportit ka për qëllim njohjen e ligjshmërise së përgjithshme të origjinës së lindjes e të zhvillimit të Edukimit e Sportit në formacione të ndryshme shoqërore duke filluar nga rendi primitiv deri në ditët tona. Një kujdes i veçantë i kushtohet evolucionit të mjeteve të perdonura në funksion të edukimit levizor si dhe funksionet e karakterin e ketij edukimi në etapa të vecanta të zhvillimit shoqëror. Në të gjithë materialin e paraqitur edukimi fizik trajtohet si një pjesë e rendeshishme integrale e formimit të përgjithshëm të personalitetit të të rinjve gjatë procesit të tyre jetësor. Me kujdes shtjellohen ndikimet e rrymave të ndryshme filozofike në vleresimin e edukimit trupor dhe të formave të realizimit te tij.

**Literatura:** 1.Misja B.-Historia e Edukimit Fizik dhe Sportit-Tirane 1997;  
2.Bushati E-Historia e Kultures Fizike- Tirane 1981.

## **V. Programi i lëndës: “Anatomi”**

Tematika e përgjedhur bazohet në njojuritë bazë që duhet të zoterojë një kandidat për mësues i edukimit fizik. Studentët, mësuesit e ardhshëm të edukimit fizik, u bie që të ndjekin zhvillimin harmonik dhe rritjen natyrore të adoleshentëve. Për këtë arsyet duhet të zoterojnë disa njojuri shkencore themelore mbi veprimtarinë muskulare, mbi anët mekanike dhe nervore të saj. Ata duhet të dinë të vlerësojnë shkallën e zhvillimit dhe dëmtimet e mundshme të kockave, muskujve dhe ligamenteve. Mësuesi i edukimit fizik duhet të kuptojë raportet që ekzistojnë ndërmjet kockës, ligamentit dhe muskulit, si dhe rolin e tyre në kryerjen e ushtrimit dhe mbajtjen e ekuilibrit të trupi. Duhet të njojin mekanizmin e qarkullimit të gjakut, frysma e marrjes si dhe proceset e metabolizmit. Mësuesi i edukimit fizik duhet të jetë i aftë të përcaktojë lëvizjet, dhe cilët muskuj janë të interesuar, në ç'menyrë e kryejnë lëvizjen dhe cili është rezultati.

**Literatura:** 1.Leksione (përgatitur nga pedagogu i lëndës).

2.Zana Cikuli. Anatomia normale e Njeriut. Tirane -2007

## **VI. Programi i lëndës: "Masazh e Kinezioterapi"**

Njohuritë mbi masazhin dhe metodikat e tij, ndërtimin e lëkurës; Teknikat e gjimnastikës korriguese dhe përdorimi i saj; Kompetencat: Të jetë i aftë të zbatojë në mënyrë korrekte terapinë lëvizore në traumat e ndryshme të organizmit të njeriut. Të njohë mirë ndërtimin e organizmit të njeriut dhe të ndërhyjë në deviacionet e mundëshme të kolonës vertebrale, të kafazit të krahërorit dhe të gjymtyrëve të poshtme. Njohuri përkatëse në programimin dhe në trajtimin e patologjive të ndryshme në organizmin e njeriut duke përdorur terapinë lëvizore.

**Literaturë:** 1.Kapedani K. Prifti Dh. Masazhi Sportiv.(1997)Tiranë.

2. Canaj P. Kapedani K. Canaj F. Kinezoterapia. (2008) Tiranë.

#### **VII. Programi i lëndës: “Biokimi Sporti”**

Në Biokimi do te merren njohuri për têrësine e reaksioneve kimike që realizohen në qelizë, për metabolizmin e qelizës. Anabolizmin dhe katabolizmin. Zbërthimi enzimatik të makromolekulave në monomerët e tyre. Çlirimini e energjisë, e cila grumbullohet në përbërje të lidhjeve fosforike (ATP, GTP etj). Biosintezën enzimatike të makromolekulave (makromerëve) përbërës të qelizës, p.sh, glucideve, lipideve, acideve nukleike, proteinave dhe kombinimet e tyre. Produktet e ndërmjetme të metabolizmit.

Kompetencat: Objektivi kryesor është ai i futjes së mësuesit të edukimit fizik në njojuritë e mekanizmave biokimike duke aplikuar principet e biokimisë të studjuar në aktivitetin fizik, të nevojshme për shëndetin dhe për çdo individ.

**Literatura:** 1.Erindi.A Lako. S - Biologjia - Cikel Leksionesh për Universitetin e Sporteve.

### **VIII. Programi i lëndës: "Biomekanikë"**

Tematika e përgjedhur bazohet në parimet themelore të aplikimit të ligjeve të fizikës tek trupat në lëvizje dhe synon marrjen e njojurive bazë të lëvizjeve. Paraqitja e koncepteve kryesore ndihmon për të vlerësuar veprimin e forcave të jashtme dhe efektet e tyre, mënyrën sesi trupi gjeneron forca për të ruajtur pozicionin, dhe sesi forcat krijojnë një aktivitet fizik në lëvizje. Konceptet bazë të parimeve biomekanike janë të nevojshme për të kuptuar më mirë analizat e mëtejshme biomekanike.

- Literatura:**
1. "Biomekanika"(Cikël Leksionesh dhe Praktikash mësimore).
  2. E. Hysenbegasi, I.Vullkaj, "Biomekanika, Tiranë,1994.
  3. "Biomekanikae ushtrimeve fizike", redaktuar nga I. Vullkaj, Tiranë, 1974.
  4. Zana Cikuli:Anatomia Normale e Njeriut . Tiranë, 2002.

### **IX. Programi i lëndës: "Shëndet dhe aktivitet fizik"**

Aktiviteti fizik, shëndeti publik dhe fitness-i, historiku dhe epidemiologjia; Reagimet metabolike, kardiovaskulare dhe respiratore gjatë aktivitetit fizik; Aktiviteti fizik, Fitnesi dhe Obeziteti; Sindromi metabolik dhe Diabeti i Tipit të 2 e ai i Tipit 1; Aktiviteti fizik, Fitnesi dhe kanceri; Testimet dhe matjet në vlerësimin funksional; Të ushtruarit e aktivitetit fizik dhe mirëqenia psikologjike; Performanca dhe fitnesi i shpinës. Osteoporoza dhe probleme të tjera që ndikohen nga aktiviteti fizik; Aktiviteti fizik, fitness-i dhe shëndeti i fëmijëve; Rekomandimet përritjen e aktivitetit fizik dhe modelet që aplikohen; Efektet e aktivitetit fizik në të moshuar; Aktiviteti fizik, Fitnesi muskular dhe shëndeti.

- Literatura:** 1.Leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës.

2. Zhurda Y. Cikël Leksionesh

### **X. Programi i lëndës: "Shëndeti Publik"**

Higjena e mjedisit ajror. Higjena shkollore. Veçoritë anatomo fiziologjike të moshave në rritje, sistemi muskular, kockor, sistemi kardio vaskular, respirator etj. Regjimi dhe ushqimi i fëmijëve në rritje. Njohuri mbi sëmundjet infektive, shkaktarët, parandalimi dhe mjekimi i tyre. Njohuri praktike dhe teorike në fushën e edukimit e të promocionit shëndetësor të grupeve të ndryshme të popullatës dhe mënyrën e komunikimit për të arritur qëllimin e kësaj veprimtarie.përbajtja e lëndës) bazohet në kompetencat që duhet të zotërojë një kandidat për mësues i edukimit fizik në formimin e tij profesional.

- Literatura:**
1. Canaj Profit, Kapedani Keti."Higjena Sportive"(2002) Tiranë, SHBLU.
  2. Roshi Enver, Burazeri Genc."Shëndeti Publik"(2006) Tiranë.
  3. Cikël leksionesh (përgatitur nga pedagogu i lëndës)

### **XI. Programi i lëndës: Metodika e Sporteve Individuale**

Ky program përmban probleme dhe çështje të caktuara që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e disiplinave sportive bazë të atletikës, gjimnastikës si dhe arteve marciale në kluadrin e organizimit dhe zbatimit të procesit të edukimit fizik në shkollë dhe jashtë saj.

Qëllimi kryesor i këtij programi është kualifikimi i mëtejshëm i specialistëve dhe mësuesëve të edukimit fizik me risi dhe shprehi metodike organizative për organizimin dhe zhvillimin e këtij procesi sipas kërkesave bashkëkohore. Për sa më lart, programi do të trajtojë probleme dhe çështje që lidhen me promovimin e disiplinave të atletikës dhe gjimnastikës si dhe sporteve me karakter ndeshës, si mjete edukuese dhe zhvilluese me vlera aplikative, me tiparet dhe veçoritë

dalluese të tyre në procesin e edukimit fizik dhe gjatë jetës së përditshme, me bazat njohëse teknike e biomekanike të disiplinave dhe nendisiplinat përkatëse të këtyre sporteve, me procesin teknik dhe metodik në përputhje me veçoritë e subjekteve sipas cikleve të mësimit si dhe procesin e organizimit dhe zhvillimit efektiv të edukimit fizik në shkollë dhe jashtë saj, në aktivitetet masive qëllimore.

**Literatura:** Lënda *Atletikë 1. Atletika; Bazat e Stërvitjes Sportive*, 2007. Dibra F.

2. "Atletika 2" 2006.

3. "Atletika 1" 2004;

Lënda *Gjimnastikë 1*. Kuqo, SH. "Bazat e Terminologjisë së Gjimnastikës" 2004;

2. Grup autorësh. "Terminologjisa e Gjimnastikës në Edukimin Fizik dhe në Sport" v. 2005.

3. Grup autorësh. "Gjimnastika" v. 1980;

4. Grup autorësh. "Gjimnastika-pjesa praktike" v. 1981.

5. Meta, A. "Metodika e Përgatitjes Lëvizore e Gjimnastëve të Rinj" v. 2001.

6. Meta, A. "Kronologjia e Gjimnastikës shqiptare dhe rrugët e zhvillimit të saj në të ardhmen"

7. "Studime Sportive" NR. 2. v. 1999.

Lënda *Arte marciale dhe Sporte Ndeshëse-*

**Mundje:**

1. Teksti mësimor "Të mësojmë mundjen", 2003.

2. Teksti mësimor "Mundja"

3. Teksti mësimor "Përgatitja fizike në mundje", 1994.

**Boks:**

1. Teksti mësimor "Boksi", 2006, R. Reka.

2. "Përgatitja tekniko-taktike e boksierit", 1992, Emil Zheçev.

3. "Përgatitja e boksierëve fillestarë", 2002.

4. Valeri Shitov. "Pergatitja e boksierëve të nivelit të lartë", 2006, Andrejeviç.

**Peshëngritje:**

1. Teksti "Peshengritja" autor P. Ferunaj;

2. Libri "Muskulimi ne stervitjen me pesha", autor P. Ferunaj;

3. Përbledhje leksionesh;

4. "Rregullore teknike e garave ne peshengritje", autor Ferunaj, Kraja.

**Spote Ndeshës dhe arte marciale:**

1. Taekwondo."Kjo eshtejeta qe kam zgjedhur", 2007.2. Monografi "Harmonizimi i ushtrimeve të teknikës me ato të forcës, kusht kryesor përmirësimin e rezultateve në peshëngritje"

## XII. Programi i lëndës: "Metodika e Lojërave Sportive"

Në programin për lëndët "Metodika e Lojërave Sportive" përfshihen tematika që lidhen me organizmin dhe zbatimin e Lojërave Sportive në procesin mësimor të edukimit fizik, kryesisht në disiplinat: Volejbolli, Basketbolli dhe Futbolli. Programi mësimor synon kualifikimin e mësuesve dhe specialistëve të edukimit fizik për ngritjen e procesit mësimor në këtë fushë në një nivel më të lartë metodiko-organizative e shkencore. Programi synon në pajisjen e specialistëve me dije dhe shprehi për zbatimin e procesit mësimor në lojërat Volejboll, Basketball dhe Futboll në një nivel më të lartë dhe në përputhje me veçoritë e cikleve të mësimit dhe të moshës së nxënësve në shkollë. Programi synon trajtimin analistik të këtyre problemeve si: promovimi i lojërave sportive, veçoritë dalluese dhe zbatuese të tyre në procesin mësimor dhe jashtë tij, problemet e teknikës dhe të mësuarit sipas veçorive të moshës, organizimi i procesit mësimor

mbi bazën e metodave dhe metodologjive konkrete dhe operative, njojja e rregullave bazë sipas veçorive dhe kërkesave të nëndegëve të lojërave sportive etj.

**Literatura:**

- a) **Volejboll** A.Shehu - Tekst mësimor ; “Volejbolli – Teknika dhe taktika”,2010.2. “Teknika e Lojës se Volejbollit”, grup autorësh.
- b) **Basketball**-Coaching basketball-Teaching and evaluating. fq 1-19 Teaching technical skills.fq 19 -111 Teaching technical skills. fq 111- 209; Games coaching.fq 209- 239;
- c) **Futboll** 1.Teksti “Futboll 1” 2003, grup autorësh;  
2.Leksion i pedagogut të lëndës.  
3.Metodika e përgatitjes së Futbollistëve të Moshës 14-18 Vjeç

**XIII. Programi i lëndës:“Edukimi Lëvizor-Motor”**

Kuptimi dhe teoritë mbi lëvizjen; lindja dhe evolimi lëvizjes; bazat shkencore të lëvizjes; bazat strukturore të lëvizjes; kategoritë shkencore të lëvizjes; zhvillimi lëvizor motor; lëvizjet lokomotore; dinamika e zhvillimit fizik motorik; aftësitë fizike; aftësitë koordinative; karakteristikat moshere të rritjes fizike; karakteristikat e rënjes fizike; kontrolli fizik lëvizor.

**Kompetencat:** Aftësimi i mësuesve të rinj me njohuritë themelore të teorisë e praktikës mësimore të veprimtarisë lëvizore dhe përdorimin e saj në edukimin përditësues të nxënësve, përritjen e performancës fizike e motore dhe në forcimin e shëndetit të tyre.

**Literatura:** 1. L. Markola ”Leksione të shkruara, lënda “Edukimi Lëvizor”- master profesional-2011-2012. L.Markola.”Përgaditja fizike e fëmijëve 6-14 vjec”,SHBLU; (2005) faqe 16-68 dhe 163-175 J.Daci, G. Subashi, B.Misja,“Teoria dhe metodologjia e edukimit fizik”, SHBLU 2003; faqe 2-17,64-67,80-103.

**XIV. Programi i lëndës: “Lojra Lëvizore”**

Mbi edukimin lëvizor. Loja lëvizore dhe edukimi. Lojrat lëvizore në programet e edukimit fizik Lojrat lëvizore dhe klasifikimi i tyre. Mësuesi në procesin mësimor me lojra lëvizore. Kompetencat: Të formojë tek studentët njohuri për procesin e të mësuarit të Lojrale Lëvizore dhe përfshirjen e lojës në orën e edukimit fizik.

**Literatura:** 1. E.Dashi; YZhurda; A.Kaçurri ”Lojrat lëvizore dhe edukimi” f. 1-76

**XV. Programi i lëndës: “Zhvillim Motor”**

Teoritë mbi Zhvillimin Motor; Rritja Fizike dhe Moshimi; Zhvillimi i Aftësive Motore në Vite; Zhvillimi Perceptual Motor; Kushtëzimet Funksionale mbi Zhvillimin Motor; Nohuritë një Kushtëzues Funksional mbi Zhvillimin Motor; Ndërveprimi i Ushtrimeve dhe Kushtëzuesve Funksional.

**Literatura:** 1.Kaçurri A. “Permbledhje leksionesh për lëndën, 2008-2012”

**XVI. Programi i lëndës: “Organizim i edukimit fizik”**

Organizim i sistemit te edukimit fizik. Institucionet perberese te edukimit fizik. Roli i mesuesit dhe nxenesit ne organizim. Sistemi i edukimit fizik. Bazat e organizmit te edukimit fizik.

Kompetencat: Aftësimi i mësuesve të rinj me njohuritë, dhe njohjen me konceptet baze te organizmit te sistemit te edukimit fizik.

**Literatura:** 1. Rizvanolli. V, Shyti, A. (2011). Organizimi institucional dhe juridik i sportit. Shblu. Tirane.

2. Leksione të shkruara.

## **XVII. Programi i lëndës: “Didaktike e EF dhe Sportit”**

Didaktika e edukimit fizik. Të mësuarit e veprimeve lëvizore. Qëllimet e edukimit fizik. Standartet e arritjes dhe përmbajtjes në lëndën e edukatës fizike. Struktura dhe procesi i organizimit të mësimit të edukimit fizik. Karakteristikat e veprimeve lëvizore. Lënda e Didaktikës së Edukimit Fizik synon në njojhen e bazave teorike dhe metodologjike të mësimdhënies e mësimnxënies në edukimin fizik. Duke përfshirë një tematikë të gjerë, që ka të bëjë me planifikimin, organizimin e drejtimin cilësor të procesit mësimor. Didaktika e Edukimit Fizik ka si bosht kryesor kërkesën për modernizimin shkencor e pedagogjik të procesit mësimor.

### **Literatura:**

1. Subashi. G.(2004)Didaktika e edukimit Fizik.Faqe:39-57; 58-116; 131-152; 152-158; 159-174; 176-182

## **XVIII. Programi i lëndës: “Pedagogji”**

Njohuri për edukimin. Edukimi me dimensionin europian. Praktika edukative. Marrëdhëniet edukative. Proçesi i komunikimit. Profesioni i mësuesit. Kompetencat që synohen të arrihen në përfundim të provimit të shtetit: Formimi me njojuritë dhe përdorim praktik i tyre në proçesin mësimor edukativ në shkollë.

### **Literatura:** 1.Marsela Shehu. Leksione të shkruara.

## **XIX. Programi i lëndës: “Edukimi dhe Promocioni i Shëndetit”**

Njohuri mbi shendetin; edukimi shendetesor; promocioni i shendetit, mjetet dhe metodat per edukmin, etj. Kompetencat: Të jetë i aftë të bëjë diagnozën edukative shëndetësore duke ndërtuar e zbatuar punën në përputhje me karakteristikat (gjini, moshë, semundje kronike, zonë urbane apo rurale).

### **Literatura:** 1.Leksione(përgatitur nga pedagogu i lëndës).

2.Stratobërdha.Dh:Edukimi & Promocioni i Shëndetit 2004

## **XX. Programi i lëndës: “Fiziologja e Ushtrimit dhe Kontrolli funksional”**

Burimet energjitike, reagimi i sistemit kardiovaskular dhe i fryshtësorit, ndikimi i kushteve klimatike e gjeografike, intensitetit të të ushtruarit dhe llojit të sportit, sipas gjinisë e moshës, mënyra e testimit të aftësive fiziko-funksionale, ligjet e përshtatjes ndaj faktorëve te jashtem, alternimin e pushimit me punën, etj.

Kompetencat: Njohuritë mbi të gjitha funksionet e aparateve dhe sistemeve të organizmit të njeriut, në kushtet e aktivitetit fizik e ngarkesave stërvitore të ndryshme.

### **Literatura:** 1.Leksione(përgatitur nga pedagogu i lëndës).

2.Canaj.P,Hoxha.K Fiziologja Sportive, Tiranë 2004.

3.Canaj. P, Kontrolli Mjekësor i Sportistëve Tiranë 2007.

4. Canaj. P, Prifti. Dh, Cina. R Praktikum Fiziologji Normale-Sportive 2005.

5.Canaj. P, Cikuli. Z Praktikum Kontrolli Mjekësor Sportiv 2005

## **XXI. Programi i lëndës:”Teknologji e edukimit fizik”**

Hyrje në teknologjinë e përdorur në edukim fizik dhe sport. Teknologja standard Teknologja e komunikimit.Teknologjite specifike të edukimit fizik & fitnessit. Teknologjite specifike të

sportit. Teknologjitet specifike të diagnostikimit dhe rehabilitimit. Të mësuarit eficent me teknologji. Teknologjia e informacionit. Të mësuarit nëpërmjet teknologjisë.

Kompetencat: studentët duhet të jenë të aftë të: tregojnë aftësi të përdorin PC në mënyrë efikase lidhur me nevojat profesionale; të tregojnë një kuptim të quartë rrëth aparateve, teknologjisë në dispozicion lidhur me parametrat e edukimit fizik dhe sportit në interes; të përgatisin një prezantim që kërkon përdorimin e standardeve të edukimit fizik dhe të teknologjisë të përshtatshme me kërkesat profesionale; të përdorin www si burim informacioni; të vlerësojnë software, teknologji dhe faqet e internetit; të krijojnë një bazë të dhënash; të vlerësojnë çështje të etikës dhe të sigurisë lidhur me përdorimin e teknologjisë; të tregojnë familjaritet me komunikimin on-line.

**Literatura:** 1.Cikël Leksionesh (dispenca & handsout).

**Per grupin e punes**

**KRYETARI**

**Prof.Asc.Dr. Fatos GJATA**

Programi i përbashkët për të gjitha nënprofesionet e Provimit të Shtetit në Mësuesi

**PROGRAMI I PËRGATITJES PEDAGOGJIKE PËR TË GJITHË MËSUESIT E RINJ**

Nr.	KOMPONENTËT E PROGRAMIT TË PEDAGOGJISË	
I	<b>Kurikula e Arsimit Parauniversitar</b>	
a.	<b>Temat</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fusha e kurrikulës</li> <li>• Zhvillimi kurrikulës</li> <li>• Hartimi kurrikulës</li> <li>• Qëllimet, synimet dhe objektivat</li> <li>• Zbatimi kurrikulës</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Allan C. Orstein dhe Francis P. Hunkins “Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet” faqe 1-45, 285 - 467</p>	
b.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Planet dhe programet mësimor</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Plani dhe programi mësimor i lëndës që secili mësues zbaton në praktikë</p>	
c.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procesi i të nxënëtit</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Sula G. Kursi leksioneve 2011</p>	
II.	<b>Metoda e mësimdhënies dhe mendimi kritik</b>	
A	<p><b>Literatura :</b> Temple, Craford et al “Strategji e mësimdhënies e të të nxënëtit në klasat mendimtare” 2006</p>	
B	<p><b>Literatura:</b> Musai B “Metodologji e Mësimdhënies” 2003, Faqe 79-164</p>	
C	<b>Temat</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Planifikimi i mësimit</li> <li>• “Metodat e mësimdhënies</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Grup Autorësh “Metodat e mësimdhënies – ( Manual për mësuesit e rinj)” 1999 faqe 56 – 119</p>	
D	<p><b>Literatura:</b> Levis Vaughn dhe Chris Macdonald “Fuqia e të menduarit kritik” 2010</p>	
E	<p><b>Literatura :</b> Jeff Zwiers “Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6 deri 12”, 2006.</p>	

<b>III</b>	<b>Aftësitë ndërkurikulare</b>	
	<p><b>Temat :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi psikologjik i moshës shkolllore</li> <li>• Përfshirja e prindërve në edukim</li> <li>• Motivacioni dhe mësuesi</li> <li>• Roli dhe shprehitë profesionale të mësuesit</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Tamo A. Karaj TH. Rapti E." Mësimdhënia e të nxënëtit" 2005 Faqe 5-62, 216-246, 293-349.</p>	
<b>IV</b>	<b>Vlerësimi nxënësve</b>	
A	<b>Literatura:</b> Mita .N. "Vlerësimi i nxënësve" - Cikël leksionesh faqe 1-90.	
B	<b>Literatura :</b> grup autorësh " Si të shkruajmë objektivat për mësimdhënien e vlerësimin" 2009	
	<p><b>Temat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi nxënësit</li> <li>• Vlerësimi mësimdhënies</li> </ul> <p><b>Literatura:</b> Grup Autorësh "Metoda të mësimdhënies. (Manual për Mësuesit e rinj)" 1999 Faqe 137 – 177 dhe 211 -223</p>	
<b>V</b>	<b>Menaxhimi klasës</b>	
A	<p><b>Temat :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhimi i klasës</li> <li>• Trajtimi diferencuar i nxënësve</li> </ul> <p><b>Literatur:</b> Tamo A. Karaj TH. Rapti E." Mësimdhënia e të nxënëtit" 2005 Faqe 246- 293.</p>	
B	<p><b>Tema :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi dhe drejtimi klasës</li> </ul> <p><b>Literatur:</b> Grup Autorësh "Metoda të mësimdhënies Manual për mësuesit e rrinj" 1999 Faqe 118 -137</p>	
C.	<b>Literatur :</b> Karaj Th. " Menaxhimi Klasës" 2009	
<b>VI</b>	<b>Psikologjia e zhvillimit</b>	
	<b>Literature:</b> Karaj. Th. "Psikologjia e zhvillimit të fëmijës" 2005	

## **PROGRAM I DREJTSHKRIMIT PËR PROVIMIN E SHTETIT NË MËSUESI**

### **I. DREJTSHKRIMI I ZANOREVE**

1. Zanorja e e theksuar dhe e patheksuar
2. Zanorja ë e patheksuar
  - 2.1 ë-ja paratheksore
  - 2.2 ë-ja pastheksore
  - 2.3 ë-ja fundore
- 3 Zanorja **u, i** dhe **y, u** dhe **y.**
4. Grupe zanoresh dhe diftongje
  - 4.1 ie dhe je
  - 4.2 ye
  - 4.3 ua, ue
- 5 Apostrofi

### **II. DREJTSHKRIMI I BASHKËTINGËLLOREVE**

1. Bashtingëlloret e zëshme në fund dhe në trup të fjalës
2. Bashkëtingëlloret nistore **sh, zh, c, s, z**
3. Bashkëtingëllorja **j**
4. Bashkëtingëllorja **h**
5. Bashkëtingëllorja **rr**
6. Bashkëtingëllorja **nj** në trup dhe në fund të fjalës
7. Grupe bashkëtingëlloresh (**mb, nd, ng, ngj**)
8. Takime bashkëtingëlloresh
  - 8.1 Takimi i **t**-së me **sh**-në
  - 8.2 Takimi i **g**-së ose i **n**-së me **j**-në
  - 8.3 Takimi i **d**-së, **s**-së, **t**-së ose i **z**-së me **h**-në
  - 8.4 Takimi i **d**-së me **t**-në

### **III. DREJTSHKRIMI I DISA FJALËVE TË HUAJA DHE I EMRAVE TË PËRVEÇËM TË HUAJ**

1. Fjalët që kanë **-ia, ie, io, iu** me **i** të patheksuar në trup të tyre
2. Fjalët me burim nga latinishtja a nga gjuhët romane, si edhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një **c** të ndjekur nga zanorja **e** ose **i**
3. Emrat e huaj të përveçëm

### **IV. ÇËSHTJE GRAMATIKORE**

1. Drejtshkrimi i disa trajtave të shumësit të emrave dhe të mbiemrave
  - 1.1 Emrat femërorë me **-ë**
  - 1.2 Emrat dhe mbiemrat mashkullorë me **-al, -an, -ar, -ec, -el, -er, -et, -ez, -ii, -ir, -al, -on, -oz, -un**
  2. Drejtshkrimi i nyjës së përparme
  3. Drejtshkrimi i fjallëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes

### **V. PËRDORIMI I SHKRONJAVE TË MËDHA**

1. Tek emrat dhe mbiemrat e personave, epitetet ose ofiqet (nofkat) që janë pjesë përbërëse e tyre, si edhe tek pseudonimet.
2. Tek emërtimet e funksioneve shtetërore, politike e ushtarake, të gradave, të titujve fetarë etj.

3. Tek emërtimet e funksioneve zyrtare e shoqërore më të larta, titujt më të lartë të nderit në RSH dhe tek emërtimet e urdhreve e të medaljeve shtetërore.
4. Tek emrat e përvecëm të botës mitologjike e fetare, si edhe tek ato të figurave e të tregimeve popullore
5. Tek emërtimet gjeografike e territoriale-administrative si edhe tek emrat e tjerë të vendeve
6. Tek emërtimet e periudhave, të ngjarjeve, të akteve e të dokumenteve historike me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare, të monumenteve historike e të monumenteve të kultures
7. Tek emërtimet zyrtare(të sotme ose historike) të institucioneve të shtetit e të partive, si edhe tek emërtimet e organizatave shoqërore e të njësive ushtarake kryesore.
8. Tek emërtimet e festave kombëtare dhe ndërkombëtare
9. Tek titujt e gazetave, të revistave e të librave.

#### **LITERATURA**

1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973
2. Gjuha letrare për të gjithë, Tiranë, 1976
3. Rami Memushaj, Shqipja standard. Si ta flasim dhe ta shkruajmë?